

**BALKAN GREEN FOUNDATION**

Prishtinë, Kosovë

**PASQYRAT FINANCIARE**

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

dhe

**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**

Përmbajtja:

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR .....	2
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE.....	4
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE .....	5
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË TË GATSHME .....	6
1. Politikat materiale kontabël.....	7
2. Politikat materiale kontabël (vazhdim) .....	8
3. Paraja dhe ekuivalentët e saj .....	8
4. Avanset dhe parapagimet .....	8
5. Llogaritë e pagueshme tregtare .....	8
6. Të hyrat e shtyra.....	9
7. Të hyrat e njohura nga grantet .....	9
8. Shpenzimet administrative.....	10
9. Shpenzimet e pagave .....	10
10. Shpenzimet e aktiviteteve.....	10
11. Shpenzimet tjera .....	10
12. Shpenzimet e partneritetit dhe nën-grantistëve .....	11
13. Kontigjencat dhe zotimet.....	11
14. Ngjarjet pasuese .....	11

## **RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR**

Për: Bordin dhe menaxhmentin e "Balkan Green Foundation"

### **Opinionit**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të "Balkan Green Foundation" (Organizata), të cilat përbëhen nga Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 dhjetor 2023, Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, dhe pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Balkan Green Foundation më 31 dhjetor 2023 dhe performancën e tij financiare dhe rrjedhën e parasë së gatshme për vitin e përfunduar më datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe kërkesat e Ligjit Nr. 06 / L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.

### **Baza për opinionin**

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti. Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përfuara të auditimit janë të majftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

### **Çështje tjera**

Pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 janë audituar nga një auditor tjetër ligjor, dhe opinionit është i pamodifikuar. Opinioni ynë mbetet i pamodifikuar në lidhje me këtë çështje.

### **Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojnë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

### **Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomali të mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimi, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përftuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Lulzim Zeka  
Auditor Ligjor

Baker Tilly Kosovo  
20 gusht 2024



BALKAN GREEN FOUNDATION  
 PASQYRA E POZITËS FINANCIARE  
 Me 31 dhjetor 2023  
 (të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

	Shënimi	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
<b>Pasuria</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	3	196,461	114,267
Avancet dhe parapagimet	4	45,374	-
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>241,835</b>	<b>114,267</b>
<b>Balanci i fondeve dhe detyrmet</b>			
Fondet e pashpenzuara		-	-
<b>Gjithsej balanci i fondeve</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Detyrimet</b>			
Llogaritë e pagueshme tregtare	5	434	-
Të hyrat e shtyra	6	241,401	114,267
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>241,835</b>	<b>114,267</b>
<b>Gjithsej balanci i fondeve dhe detyrimet</b>		<b>241,835</b>	<b>114,267</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe nënshkruar me 20 gusht 2024 në emër të Menaxhmentit të organizatës nga:

Drejtor Ekzekutiv

Menaxhere e financave dhe administratës

Agron Demi

Doruntina Murati



**balkan  
green  
foundation**

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 14 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

BALKAN GREEN FOUNDATION  
 PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE  
 Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023  
 (të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

		Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
	Shënimi		
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat e njohura nga grantet	7	319,777	434,977
<b>Gjithsej të hyrat</b>		<b>319,777</b>	<b>434,977</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzimet administrative	8	22,253	29,868
Shpenzimet e pagave	9	150,357	158,439
Shpenzimet e aktiviteteve	10	57,556	204,786
Shpenzime tjera	11	5,416	1,884
Shpenzimet e partneriteteve dhe nën-grantistëve	12	84,195	40,000
<b>Gjithsej shpenzimet</b>		<b>319,777</b>	<b>434,977</b>
<b>Teprica / (mungesa) e fondeve</b>		<b>-</b>	<b>-</b>

*Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 14 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.*

BALKAN GREEN FOUNDATION  
 PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË TË GATSHME  
 Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023  
 (të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

	Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2022
Aktiviteti operativ	-	-
Teprica / (mungesa) e fondeve për vitin	-	-
Ndryshimi në llogaritë e pagueshme	434	-
Ndryshimi në avanse dhe parapagime	(45,374)	-
<u>Rrjedha neto e parasë nga aktiviteti operativ</u>	<u>(44,940)</u>	<u>-</u>
 Aktiviteti financues		
Ndryshimi në të hyrat e shtyra	127,134	(73,714)
<u>Rrjedha neto e parasë nga aktiviteti operativ</u>	<u>127,134</u>	<u>(73,714)</u>
 Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë së gatshme	82,194	(73,714)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	114,267	187,981
<u>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</u>	<u>196,461</u>	<u>114,267</u>

*Shënimet shoqëruese nga 81 deri në 14 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.*

## 1. Organizata dhe aktivitetet

Balkan Green Foundation është themeluar më 15 Janar 2014 me numër të regjistrimit 5200289-3. Themelues të organizatës Balkan Green Foundation ("BGF") janë Visar Azemi dhe Hilda Dimco. Drejtor ekzekutiv i organizatës është Agron Demi.

Adresa e OJQ-së:  
Rr. 2 Korriku nr. 2/3 sheshi Nëna Terezë; 10 000 Prishtinë, Kosovë

### Misioni, qëllimi dhe aktivitetet e organizatës

Qëllimi i organizatës është të mbroje dhe promovojë zhvillimin e qëndrueshëm në fushën e energjisë në rajon. Fondacioni BGF fokusohet në promovimin e mbrojtjes së mjedisit, zhvillimin e sektorit të energjisë, në informimin e ndryshimeve klimatike, të cilat ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në vend dhe rajon.

## 2. Politikat materiale kontabël

### 2.1. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 06/L-043 Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo-qeveritare dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Kosovë. Pasqyrat financiare janë përgatitur dhe prezantohen në bazën akruale dhe në pajtueshmëri me politika dhe procedurat kontabël dhe praktikant e përgjithshme.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuar për çdo lloj aseti, detyrimi, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes përshkruhen më plotësisht në politikat kontabël si në vijim.

### 2.2. Valuta funksionale dhe transaksionet në valuta të huaja

Organizata Balkan Green Foundation ('organizata') i regjistron transaksionet në Euro. Të gjitha shumat e raportuara në Pasqyrën e pozitës financiare dhe në ndryshimet në asetet neto janë raportuar në Euro. Transaksionet në valuta të huaja regjistrohen sipas normave të këmbimit në fuqi me datën e transaksionit. Mjetet monetare dhe detyrimet monetare në valuta të huaja janë konvertuar sipas normës së këmbimit në datën e Bilancit të Gjendjes. Fitimi apo humbja si rezultat i këmbimit është regjistruar në Pasqyrën e të Ardhurave.

### 2.3. Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj regjistrohen në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare të shprehura në valuta të huaja rikthehen me kursin e këmbimit në fund të periudhës raportuese. Diferencat në valutë të huaj që vijnë nga ri-përkthimi njihen në fitim ose humbje.

### 2.4. Tatimi në të ardhura

Organizata është një organizatë joqeveritare (OJQ), donacionet e të cilave janë pranuar në vitin raportues janë përdorur për realizimin e misionit të organizatës. Sipas ligjit nr. 06 / L-105 për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave, OJQ-të, të ardhurat Gjithseje të të cilave përdoren për qëllimet e tyre të përfitimit publik, përjashtohen nga taksat.

### 2.5. Prona, impiantet dhe pajisjet

Organizata nuk përdor politikë mbi kapitalizimin e pasurive joqarkulluese por i debiton përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse (shpenzimeve) vjetore. Organizata asetet jo-qarkulluese i njih shpenzim të vitit në momentin e ndodhjes, por gjithashtu mban një listë të aseteve specifike sipas donatorëve, manualeve dhe politikave të brendshme.

### 2.6. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përfshijnë para në dorë dhe para të depozituara në bankë.

## 2. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

### 2.7. Të hyrat

Të hyrat e organizatës paraqesin donacionet e pranuar nga donatorët/grantet. Të hyrat njihen kur fitohen në vend se kur pranohen dhe shpenzimet njihen kur ndodhin në vend se kur paguhen. Të hyrat njihen në nivelin e shpenzimeve të ndodhura dhe trajtohen sipas 'SNK 20'. Pjesa mbetur prezantohet si e hyrë e shtyrë apo si fonde të mbajtura në dispozicion për shfrytëzim në të ardhmen.

### 2.8. Shpenzimet operative dhe administrative

Organizata njihet shpenzimet në momentin e ndodhjes. Shpenzimet regjistrohen sipas bazës akruale. Shpenzimet e organizatës përbëhen nga shpenzimet e personelit, shpenzimet operative dhe administrative, programore dhe tjera të përgjithshme.

### 2.9. Grantet e shtyra / Të hyrat e shtyra

Të hyrat e shtyra janë ato të hyra / donacione për të cilat paratë e gatshme janë arkëtuar nga organizata, por ende nuk janë shpenzuar. Si pasojë kjo përgjegjësi ndodh kur organizata 'BGF' arkëton fondet paraprakisht për një projekt që do të zbatohet në të ardhmen. Njohja e të hyrave bëhet në momentin e ndodhjes së shpenzimeve.

### 2.10. Përfitimet e punonjësve

Organizata paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore mbi skemën pensionale të punonjësve të saj. Kontributet pensionale përlllogariten 5% në bazë të pagave bruto, të cilat deklarohet dhe paguhet në baza mujore, në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). Organizata nuk ka asnjë përgjegjësi shtesë në lidhje me këtë plan. Kontributet shpenzohen kur ndodhin.

## 3. Paraja dhe ekuivalentët e saj

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Paraja në bankë	196,458	114,217
Paraja në arkë	3	50
<b>Gjithsej</b>	<b>196,461</b>	<b>114,267</b>

## 4. Avanset dhe parapagimet

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Huazimet e dhëna	10,000	-
Bashkë përfituesit	35,374	-
<b>Gjithsej</b>	<b>45,374</b>	<b>-</b>

## 5. Llogaritë e pagueshme tregtare

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Llogaritë e pagueshme	434	-
<b>Gjithsej</b>	<b>434</b>	<b>-</b>

BALKAN GREEN FOUNDATION  
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE  
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

6. Të hyrat e shtyra

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Gjendja në fillim	114,267	187,981
Fondet e pranuar	446,911	361,263
Shpenzimet	(319,777)	(434,977)
Gjendja në fund	241,401	114,267

7. Të hyrat e njohura nga grantet

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2023 të hyrat e njohura paraqiten në shumën prej 319,777 Euro (Për vitin 2022: 434,977 Euro). Respektivisht, organizata njeh të hyrat në momentin e ndodhjes së kostos, që nënkupton, të hyrat janë njohur në shumën e shpenzimeve të ndodhura përgjatë kësaj periudhe.

	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
Të hyrat nga RBF	103,392	137,548
Të hyrat nga Green Cross	13,141	132,545
Të hyrat nga Erasmus +	1,480	46,485
Të hyrat nga EUKI	555	39,870
Të hyrat nga BTD	-	19,370
Të hyrat nga RYCO	-	15,183
Të hyrat nga HBS	10,024	14,807
Të hyrat nga UN	-	14,219
Të hyrat nga SĚEPA	12,721	11,519
Të hyrat nga ĚBD	37,738	1,321
Të hyrat nga Youth Alliance (EACEA)	-	200
Të hyrat nga Rise (AFD)	19,179	-
Të hyrat nga KFOS	5,205	-
Të hyrat nga Smart Ballkans (Norwegian Embassy)	8,559	-
Të hyrat nga Ěorld Bank	96,013	-
Të hyrat tjera	11,772	1,910
<b>Gjithsej</b>	<b>319,777</b>	<b>434,977</b>

7.1. Të hyrat e arkĚtuara gjatĚ vitit

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2023, organizata arkĚtoi fonde nga donatorĚt në shumĚn prej 446,911 Euro (për vitin 2022; 361,263 Euro). PasiqĚ të hyrat njihen/amortizohen në shumĚn e shpenzimeve të ndodhura pĚrgjatĚ periudhĚs fiskale, rrjedhimisht teprica/mungesa e fondeve alokohet në balancĚn e mbetur të të hyrave të shtyra, ashtu siq shpaloset edhe në shĚnimin 6. TĚ pasqyrave financiare.

BALKAN GREEN FOUNDATION  
 SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE  
 Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023  
 (të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

8. Shpenzimet operative dhe administrative

	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
Shpenzimet e zyrës	6,290	11,950
Shpenzimet e qirasë	9,231	9,231
Shpenzimet e auditimit	5,039	7,784
Shpenzimet e mirëmbajtjes së web-faqës	-	903
Shpenzimet profesionale	1,694	-
<b>Gjithsej</b>	<b>22,253</b>	<b>29,868</b>

9. Shpenzimet e pagave

	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
Pagat bruto	150,357	151,186
Kontributi pensional i punëdhënsit	-	7,253
<b>Gjithsej</b>	<b>150,357</b>	<b>158,439</b>

10. Shpenzimet e aktiviteteve

	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
Aktivitete ndërkombëtare dhe rajonale	-	77,667
Transferta për partnerët	-	74,095
Investime	400	24,608
Udhëtime	4,347	4,954
Pajisje për aktivitete	6,277	-
Evente/workshops/Konferenca	30,464	-
Aktivitete të ndryshme	16,069	23,462
<b>Gjithsej</b>	<b>57,556</b>	<b>204,786</b>

11. Shpenzimet tjera

	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
Shpenzimet tjera	5,416	1,884
<b>Gjithsej</b>	<b>5,416</b>	<b>1,884</b>

BALKAN GREEN FOUNDATION  
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE  
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

12. Shpenzimet e partneritetit dhe nën-grantistëve

	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
Partneriteti: Balkan Green Ideas	35,606	40,000
Nën- grantist: Lëvizja Fol	24,022	-
Nën-grantist: ODK	24,567	-
<b>Gjithsej</b>	<b>84,195</b>	<b>40,000</b>

13. Kontigjencat dhe zotimet

*Çështjet ligjore*

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, organizata nuk ka qenë e involvuar në ndonjë çështje ligjore.

14. Ngjarjet pasuese

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së autorizimit të pasqyrave financiare që kërkojnë rregullime ose shpalesje në pasqyrat financiare.